

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENSINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

22.11 2012

SCC-09-0009

PADITËSIT

1. D.K., XX

2. S.K., XX

Që të dy të përfaqësuar nga avokati XX

Kundër

TË PADITURIT

XX, NSH, XX

Përfaqësuar nga

1. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit përfaqësuar nga UNMIK-u, TSS AHQ, Prishtinë
2. Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Ilir Konushevci, Nr. 8, Prishtinë

Kolegji i parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet e Lidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në përbërje prej Alfred Graf von Keyserlingk Kryetar, Shkelzen Sylaj dhe Cerim Fazliji, Gjyqtarë, pas seancës të mbajtur me 1 nëntor 2012, lëshon si në vijim

Aktgjykim

- 1. Padia është pjesërisht e bazuar.**
- 2. Paditësit janë pronarë të pronës së patundshme P-71914042-01026-1, zona kadastrale Llapllasellë, Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë, në vendin e quajtur “ Cizmine te prroni” me sipërfaqe prej 2514 metra katror.**

- 3. E Paditura obligohet që të pajtohet që Paditësit të regjistrohen nga Zyra Kadastrale në Prishtinë si pronarë të pronës së patundshme P-71914042-01026-1, zona kadastrale në Llapllasellë, Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë, në vendin e quajtur “ Cizmine të prroni” me sipërfaqe prej 2514 metra katror.**
- 4. Padia për kompensimin e shumës prej 53.865,00 eurove për pronën e patundshme P-71914042-01048-0, zona kadastrale Llapllasellë, Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë, refuzohet si e pabazuar.**
- 5. Paditësi nuk kompensohet për shpenzimet e tij procedurale dhe as për shpenzimet për ekspert.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 23 janar 2009, paditësit kanë parashtruar padi pronësore lidhur me ngastrën kadastrale nr. 1048, me sipërfaqe prej 0.35.97 ha, dhe ngastrën kadastrale nr. 1026, me sipërfaqe prej 0.25.14 ha, që gjenden në Zonën Kadastrale Llapnasellë, Komuna e Prishtinës.

Sa i përket ngastrës kadastrale nr 1026, ata kërkojnë që e paditura të obligohet që t’ua njeh paditësve pronësinë dhe që të pajtohet se ata janë regjistruar në kadastër si pronarë.

Sa i përket ngastrës kadastrale nr. 1048, ata kërkojnë 53.865,00 euro si kompensim monetar.

Paditësit po ashtu kërkojnë riimbursimin e shpenzimeve të tyre procedurale.

Me vendimin Nr. 109/64 të datës 25 janar 1964 të Komisionit për Komasaion të Kuvendit Komunal të Prishtinës ishte vendosur që ngastrat kadastrale nr. 1654 dhe 1649 që i takonin Z.K., të atit të paditësve, të barten tek KBI XX si përfituese në këmbim të ngastrave kadastrale nr. 1047, 1048 dhe 1026, të cilat me të njëjtin vendim i janë bartur të atit të paditësve. KBI XX ka pranuar obligimin që bartja të regjistrohet në kadastër. Z.K. është pajtuar me rigrupimin e tokës në favor të së paditurës, por ai ka kundërshtuar kompensimin që i është dhënë atij duke thënë se ai ka qenë i pamjaftueshëm. Mirëpo, ai nuk e ka ankimuar por e ka shfrytëzuar token e re e cila i është bartur atij dhe dy djemtë e tij–paditësit janë duke e shfrytëzuar atë edhe sot pa ndonjë pengesë. Pasi që shfrytëzimi nga ana e tyre nuk është penguar dhe /apo kundërshtuar deri në vitin 1990 prej askujt , Paditësit më parë nuk kanë

marrë ndonjë hap ligjor. Vetëm kur privatizimi kishte filluar, ata kanë ndërmarrë veprime ligjore në këtë lëndë për mbrojtjen e shfrytëzimit nga ana e tyre.

Me 15 shkurt 1979, Z.K. ka vdekur dhe me 20 korrik 1983 Gjykata Komunale në Prishtinë ka lëshuar një aktvendim duke cekur se të dy paditësit janë trashëgimtarët e tij të vetëm dhe ekskluziv pasi që trashëgimtarët tjerë nuk i kanë pranuar hiset e tyre. Ky aktvendim e quan patundshmëri shtëpinë me tokë bujqësore, por jo edhe dy ngastrat të cilat janë çështje e kësaj lënde. Ky aktvendim po ashtu nuk është ankimuar.

Ngastra tokësore 1026 ka mbetur e regjistruar në emër të së paditurës, ndërsa ngastra 1048 është regjistruar si pronë private në emër të B.N.

Me 27 gusht 2009, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ishte ftuar në padi si e paditur.

Në mbrojtjen ndaj padisë së datës 1 tetor 2009, AKP ka cekur se padia duhet refuzuar si e pabazuar. Paditësit, sipas mendimit të së paditurve, nuk kanë të drejtë në ngastrat kadastrale të kërkuara, nr 1048 dhe nr 1026, pasi që kjo pronë nuk është përfshirë në Vendimin e prezantuar mbi Trashëgiminë. E paditura ka cekur se paraardhësi i paditësit asnjëherë nuk e ka kontestuar vendimin mbi komasacionin, edhe pse ai e ka pasur mundësinë e ankesës në organet administrative dhe si një mjet i jashtëzakonshëm edhe në Gjykatën Supreme. E paditura thotë se padia bën fjalë për zbatimin e vendimit mbi komasacionin, dhe se për këtë arsye paditësi ka qenë dashur ta hapin procedurën administrative. Lidhur me ngastrën kadastrale nr 1048 në pronësi private, sipas mendimit të së paditurës, paditësit është dashur që të parashtrajnë padi në gjykatën kompetente e jo në Dhomën e Posaçme.

Në mbrojtjen ndaj padisë të datës 5 tetor 2009, UNMIK-u në emër të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) thekson se padia duhet të refuzohet si e pabazuar. AKM thotë se padia pronësore nuk është mbështetur me provat e paraqitura. Aktvendimi mbi Trashëgiminë i vitit 1983 nuk mbanë ndonjë reference për pronën e përshkruar në padi dhe se paditësit nuk kanë tentuar që të kërkojnë pronësi për ato ngastra gjatë procedurës së trashëgimisë. Pastaj, trashëgimtarët të cilët kishin hequr dorë nga trashëgimia në vitin 1983 tani do të mund të shfaqin interes lidhur me këto prona pas që ata nuk kanë qenë pjesë e procedurës së trashëgimisë. AKM

cekë se në bazë të vendimit mbi komasacionin të vitit 1964 i ati i paditëse në fakt e ka refuzuar tokën e cila i është dhënë në këmbim.

Pas seancës dëgjimore të datës 18 maj 2012, gjykata, me 3 gusht 2012 ka lëshuar një urdhër sqarimi për Agjencinë Kadastrale të Kosovës duke kërkuar informacion rreth asaj se kush dhe kur ka kërkuar që B.N. të regjistrohet si pronar i ngastrës nr. 01048. Me të njëjtin urdhër, gjykata gjithashtu ka kërkuar dorëzimin e ndonjë kërkesë të tillë me shkrim dhe ndonjë deklaratë tjetër apo kontratë e cila në kontekst të regjistrimit të B.N. si Posedues është dërguar në Agjencinë Kadastrale apo paraardhëses së saj (faqe 96, 97 e dosjes së gjykatës). Agjencia Kadastrale e Kosovës është përgjegjës se ata nuk kanë informacion të tillë dhe se kërkesa duhet drejtuar ZKK të Prishtinës apo ZKK të Gracanicës (faqe 114 e dosjes së gjykatës). Kërkesa, prandaj, i është drejtuar ZKK në Gracanicë, dhe se ende nuk ka ndonjë përgjigje.

Po ashtu, pas seancës dëgjimore të datës 18 maj 2012, gjykata ka lëshuar një urdhër duke kërkuar nga XX ekspert juridik një vlerësim për vlerën e ngastrës 01048. Në përgjigjen e tij të datës 8 tetor 2012, ai ka vlerësuar se vlera është 53955 euro (faqe 136 deri 139 e dosjes së gjykatës).

Në seancën dëgjimore të datës 1 nëntor 2012, e caktuar për në ora 11:00 Agjencia Kosovare e Privatizimit është paraqitur pa avokat të regjistruar, edhe pse ajo është paralajmëruar me urdhrin e gjykatës së datës 8 gusht 2012 se ajo duhet të përfaqësohet me avokat të regjistruar. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit është paraqitur me avokat, mirëpo e ka lëshuar gjykatën para orës 11:55 kur gjyqtari e ka njoftuar për fillimin e shqyrtimit të kësaj lënde. Kjo fillim i seancës është shtyrë sepse lënda paraprijëse ka pasur nevojë për shqyrtim më të gjatë se sa ishte parashikuar.

Arsyetimi ligjor

I Në lidhje me pronën e patundshme P-71914042-01026-1, zona kadastrale Llapllasellë, Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë ishte e obligueshme të shqiptohet Aktgjykimi në mungesë kundër të paditurit.

I Padituri nuk u përfaqësua si duhet në seancën e fundit dëgjimore të datës 1 nëntor 2012 andaj edhe duhet të konsiderohet se nuk është paraqitur (Neni 52.1 i Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet e Lidhura me Agjencinë Kosovare të

Privatizimit (në vijim: Shtojce e LDHP-së), padia është e pranueshme dhe se faktet e pohuara nga paditësi janë në mbështetje të padisë (Neni 52. Seksioni 1 i Shtojcës së LDHP-së), padia është e pranueshme dhe se faktet e pohuara nga paditësi e mbështesin padinë (Neni 52. paragrafi 2 i shtojcës së LDHP-së). Ndryshe nga Neni 151. 1b të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Ligji Nr. 03/L-00, aktgjykimi në mungesë kundër të paditurës mund të merret edhe nëse i padituri ka paraqitur parashtrësë duke iu kundërvënë padisë.

1.

Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka mundur ta përfaqësojë vlefshëm i Paditurit, sepse ajo është paraqitur në seancë dëgjimore pa avokat të regjistruar.

Çdo palë, pos personave fizik, duhet patjetër të përfaqësohet para Dhomës së Posaçme nga ndonjë avokat (Neni 24 Shtojca e LDHP-së 04/L-033). Kjo gjithashtu zbatohet edhe për NSH-të e përfaqësuara nga AKP. Formulimi i fjalëve në këtë dispozitë nuk tregon se pse nuk duhet të zbatohet kjo. Nenet 73, 74, 85 dhe 86 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (Ligji Nr. 03/L006, LPK), që rregullon se kush mund të jetë palë, cilat veprime mund ti ndërmerret një palë dhe kush mund ta përfaqësojë një palë lejon që palët dhe përfaqësuesit të cilët nuk janë avokatë të regjistruar të veprojnë në gjykatë por lidhur me këto dispozita Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së është Lex Posterior dhe Lex Specialis. Ligjvënësi ka lëshuar Nenin 24 të Shtojcës së LDHP-së kur LPK veç ekzistonte dhe ai, me Nenin 24 të Shtojcës së LDHP-së, ka rregulluar një procedurë të veçantë në një gjykatë të veçantë, ndryshe nga gjykatat tjera të Kosovës. Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së po ashtu e zëvendëson Nenin 29 të Ligjit mbi AKP-në (04/L-034, LAKP) sepse ai është nxjerrë më vonë dhe nuk e rregullon përfaqësimin në përgjithësi, siç e rregullon LAKP, por në veçanti përfaqësimin pranë DHPGJS-së. Kjo vlen gjithashtu edhe për Nenin 29. 2 të LAKP-së i cili e rregullon ‘qëndrimin ligjor të’ Agjencisë për realizimin e një të drejte të ndonjë ndërmarrje në një gjykatë kompetente në emër të ndërmarrjes së caktuar.

Rregullimi ligjor se personat fizikë nuk kanë nevojë për avokat kurse të gjithë të tjerët kanë nevojë për avokat nuk i cenon Nenet 73 dhe 74 të KPK-së. Kjo nuk është e mundur sepse Nenet 73 dhe 74 nuk zbatohen. Ata janë zëvendësuar me Nenin 24 të Shtojcës së LDHP-së.

Kërkesa për t'u përfaqësuar nga avokati nuk është shkelje e së drejtës kushtetuese për barazi para ligjit. Mund të mbetet e hapur çështja se nëse AKP si 'organ publik' (Neni 1. i LAKP-së) mund të kërkojë të drejtën themelore të barazisë e cila është historikisht dhe në kontekstin kushtetues një e drejtë e personave fizikë dhe subjekte ligjore private kundër shtetit, e jo e drejta e një organi shtetëror kundër shtetit. I Padituri ka të drejtë që të trajtohet si i barabartë pa marrë parasysh se ata kanë arsyeshem dhe në mënyrë jo diskriminuese aspekte të dallimit. Nuk është as e paarsyeshme e as diskriminuese që të privilegohen personat fizikë para gjykatës në raport me subjektet ligjore (apo të një autoriteti publik shtetëror). Shpesh, nëse jo rregullisht, personat fizikë nuk kanë mjete financiare për ta paguar avokatin. Kjo sipas aspekteve kushtetuese është arsye e mjaftueshme për privilegjimin e tyre në paraqitjen para DHPGJS-së pa avokat.

Si përfundim mund të thuhet se e paditura si çdokush tjetër pos personave fizikë duhet patjetër të përfaqësohet para Dhomës së Posaçme me ndonjë avokat i cili është anëtar i shoqatës apo odës së avokatëve. Pasi që e paditura nuk është përfaqësuar me avokat të regjistruar duhet të konsiderohet se ajo nuk është paraqitur në gjykatë.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, po ashtu, nuk e ka përfaqësuar të paditurën sepse përfaqësuesi i saj është larguar para fillimit të kësaj lënde. Thirrja e kësaj lënde është bërë 55 minuta pas kohës së përcaktuar, por palët dhe përfaqësuesit e tyre duhet ta kenë parasysh se seancat dëgjimore mund të thirren për më vonë sepse lënda paraprijëse ka pasur nevojë për më shumë kohë sesa është parashikuar. Ata duhet të presin. Pasi që Agjencia Kosovare e Mirëbesimit nuk është paraqitur në seancë, gjykata nuk ka nevojë që të vendosë në këtë rast se nëse Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ende e ka mandatin dhe përgjegjësinë ta përfaqësojë të paditurën apo nëse ky mandat dhe kjo përgjegjësi është pushuar me Nenin 1 dhe 31 të Ligjit Nr. 04/L-033 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2.

Padia është e pranueshme dhe faktet e pohuara nga paditësit e mbështesin padinë e tyre në lidhje me pronën e patundshme P-71914042-01026-1, zona kadastrale Lapllasellë, Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë (Neni 52.3 i Shtojcës së LDHP-së).

Nëse një palë pas ftesës së rregullt nuk paraqitet në seancë apo nuk paraqitet me përfaqësim të duhur, gjykata duhet ta gjykojë lëndën jo në bazë të

provave apo dëshmime por ekskluzivisht në bazë të asaj se çka pohon pala tjetër. Neni 52.3 i Shtojcës së LDHP-së). Vetëm pohimet mjaftojnë. Se nëse faktet e pohuara janë vërtetuar apo jo nuk ka ndonjë lidhje. Për këtë arsye, gjykata nuk ka pasur obligimin ta vlerësoj nëse paditësit e kanë vërtetuar se ata janë trashëgimtarët e babait të tyre, të ndjerit Z.K. dhe nëse ekspertiza e ekspertit gjyqësor, Inxh. dip. XX është provë e vlefshme se patundshmëria 01048 ka vlerën e 53955.00 Eurove.

Me vendimin e Komisionit për Rigrupim të Tokës Bujqësore të Komunës së Prishtinës (faqe 14 dhe 15 të dosjes së gjykatës) Z.K. u bë pronar i pronës së patundshme **P-71914042-01026-1**. Ky vendim është dashur të implementohet me regjistrimin e Z.K. si pronar i ri i ngastrave 1026 dhe Kombinati “XX” është dashur që ta marrë barrën që ta bëjë këtë por nuk e ka bërë këtë. Mirëpo ndryshimi i vlefshëm i pronësisë i realizuar me një akt të pushtetit lokal, Komisionit për Rigrupim të Komunës së Prishtinës nuk varet në ndryshimet në Kadastër. Ka qenë e vlefshme pa të.

Fakti se i ati i paditësve e ka kundërshtuar dhënien atij të kësaj ngastre si kompensim nuk është relevante. Ai e ka marrë atë në posedimin dhe nuk ka marrë ndonjë veprim kundër bartjes së ngastrës nr 1026 tek ai. Po ashtu tani trashëgimtarët e tij nuk e kundërshtojnë Vendimin për Rigrupim por kërkojnë që ai të implementohet plotësisht me regjistrimin e tyre në kadastër.

Azhurnimi i të dhënave në kadastër nuk ka efekt bazor (konstituitiv) por vetëm deklarativ. Nuk ka arsye se pse të mos bëhet azhurnimi në kadastër tani. Është obligim i të paditurës e cila është regjistruar gabimisht si pronare të pajtohet me ndryshimin e Kadastrës. Vendimi mbi rigrupimin e tokës i datës 25 janar 1964 e obligon atë që ta bëjë këtë.

Paditësit nuk e kanë humbur të drejtën e tyre për t’u regjistruar si pronarë.

Bartësi i një të drejte e humb këtë të drejtë nëse nuk e pretendon atë për një periudhë shumë të gjatë kohore dhe për këtë arsye i padituri ka mundur ta justifikonte besimin se e drejta nuk do të pretendohet asnjëherë as në të ardhmen.

Është e vërtetë se i ati i paditësve dhe paditësit për afro 40 vite nuk e kanë kërkuar regjistrimin në kadastër. Por arsyeja është se ata e kanë shfrytëzuar patundshmërinë të papenguar. E paditura nuk ka mundur kurrë të prezumojë

se ata nuk e kanë kërkuar regjistrimin sepse ata nuk insistojnë në të drejtën pronësore.

Tani ata duhet të regjistrohen si pronarë.

II Në lidhje me kompensimin monetar për pronën e patundshme P-71914042-01048-0, zona kadastrale Llapllasellë, Zyra Kadastrale Komunale Prishtinë,

Kjo padi refuzohet si e pabazuar, jo në bazë të mosparaqitjes (mungesës) së të Paditurit por në bazë të asaj se Paditësit nuk kanë pohuar fakte të mjaftueshme të cilat e mbështesin padinë (Neni 52.3 i LDHP-së).

Është e vërtetë se kjo ngastër me Vendimin për Rigrupim të datës 25 janar 1964 gjithashtu është bartur në pronësi të të atit të paditësve dhe kjo do të thotë se paditësit kanë mundur ta kenë trashëguar atë. Por mbajta e të paditurës përgjegjëse për kondensim monetar do të kërkonte ngritjen e një padie apo mosveprim të së paditurës në shkelje të të drejtave të paditësve apo të të atit të tyre. Paditësi nuk e ka pohuar një padi të tillë apo mosveprim. Ai vetëm cekë se patundshmëria tani është bartur te B.N. Ky fakt i vetëm nuk e bën të paditurën përgjegjëse. Deri më tani faktet e pohuara nga paditësi nuk e mbështesin mjaftueshëm padinë e tij (Neni 52.3 i Dhomës së Posaçme

Shpenzimet e paditësve

Shpenzimet e paditësve nuk kompensohen.

Sa i përket asaj që paditësi i ka paguar shpenzimet për ekspertin, ai nuk kompensohet sepse këto shpenzime vetëm duhet që atribuohen kërkesës për kompensim monetar të ngastrës nr 1048 e cila është refuzuar. Shpenzimet tjera të paditësit nuk kompensohen sepse ato nuk janë specifikuar.

Shpenzimet gjyqësore

Gjykata nuk i cakton shpenzimet gjyqësore pasi që presidiumi deri me tani nuk ka nxjerrë plan më shkrim i cili miratohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57, paragrafi 2 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme). Kjo do të

thotë se deri me tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për ngarkimin e shpenzimeve.

Këshillë juridike

Kundër këtij Vendimi, përderisa ai është Aktgjykim në Mungesë, kundër të paditurës (Nr 2 dhe 3 e diapozitivit) e paditura mund të parashtrojë një kërkesë në Dhomën e Posaçme për anulimin e Aktgjykimit në Mungesë. Kërkesa e tillë e bërë brenda një muaji nga dita e dorëzimit të Aktgjykimit në Mungesë.

Kundër pikës nr. 4 dhe 5 të diapozitivit të këtij **Aktgjykimi** paditësit mund të paraqesin apel. Apeli i tillë mund të dërgohet në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda njëzet e një 21 ditësh. Apeli po ashtu i dërgohet palës tjetër dhe Kolegjit Gjykses nga Apeluesi rrenda 21 ditëve. Apeluesi ia dërgon Kolegjit të Apelit një dëshmi se ai ia ka dorëzuar apelin edhe palëve tjera.

Afati i parashkruar kohor fillon të llogaritet në mesnatën e ditës, kur Apeluesit i dorëzohet aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon apelin si të pranueshëm, nëse Apeluesi nuk e ka parashtruar atë brenda afatit të përcaktuar.

E paditura mund të paraqes përgjigje në Kolegjin e Apelit brenda 21 ditëve nga data kur asaj i është dorëzuar apeli, duke ia dërguar përgjigjen apeluesit por edhe palëve tjera.

Apeluesi pastaj, i ka në dispozicion 21 ditë pasi që i është dërguar përgjigja ndaj apelit të tij, që të paraqes përgjigjen e tij në Kolegjin e Apelit dhe t'ia dërgojë atë edhe palës tjetër. Pala tjetër pastaj ka 21 ditë afat pasi që ti dorëzohet përgjigja e apeluesit të dërgojë apeluesit dhe Kolegjit të Apelit kundërpërgjigjen e tij.

Alfred Graf von Keyserlingk
Gjyqtar Kryesues